

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 630 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 69, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Projekti për bashkëpunimin e Institutit të Arkeologjisë dhe Univesitetit të Barit-Itali"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Luan Përzhita dhe Prof. Roberta Belli, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë "Projekti për bashkëpunimin e Institutit të Arkeologjisë dhe Univesitetit të Barit-Itali"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Luan Përzhita dhe Prof. Roberta Belli, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimi i punës kërkimore-shkencore për vitin 2017 do të jetë në plotësimin me dokumentacionin tekniko - shkencor të fortifikimit helenistik të Bylisit dhe qytetit antik të Klosit.
 - Organizimin e sondazheve tek stoa, stadiumi, teatri dhe porta jugore.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO